



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.375/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur ndaj Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve(QNR)-Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos procedimit të 4.639 fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës si fletëvotime të rregullta dhe mos numërimit të të njëjtave në Q.N.R, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 19.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i palejueshëm apeli i evidentuar si Anr.375/2019 e datës 17.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që 4.639 fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës, të pranuar në KQZ prej datës 08.10.2019 deri më datë 11.10.2019, të procedohen si fletëvotime të rregullta dhe të lejohet numërimi i të njëjtave në Q.N.R.

A r s y e t i m

Me datë 17.10.2019 subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.375/2019, kundër QNR-KQZ me të cilën theksohet se me datë 16.10.2019, rreth orës 23:00 ka përfunduar numërimi i fletëvotimeve me post, nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë vendit, me të cilën janë numëruar gjithësej, 13,491 fletëvotime të ardhura me 11,922 dërgesa postare. Subjekti politik, LVV pretendon se nga vëzhguesit e tyre janë informuar se edhe 4639 pako me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë Kosovës, e të cilat ende nuk kanë ardhur dhe numëruar në QNR. Më tutje subjekti politik LVV, thekson se pakot prej 4639, fletëvotimeve janë të domosdoshme të numrohen për faktin se përmes këtij numrimi realizohet vullneti i qytetarve të cilët jetojnë jashtë vendit si dhe me këtë realizohet e drejta Kushtetuese e tyre për të zgjedhur siç parashihet në nenin 45, të Kushtetutës së Kosovës. Subjekti politik LVV thekson se kanë legjitimitet të plot për të kërkuar numrimin e çdo vote të ardhur nga diaspora dhe të dorëzuar në KQZ, me qëllim të respektimit të Kushtetutës së Kosovës dhe pretendojn se numrimi i të gjitha votave të vlefshme ndikon në shtimin e numrit të mandateve, të cilat do të përfaqësojnë interesat ligjore dhe Kushtetuese të më shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pavarisht se cili subjekt politik i takojn ato vota. Në kuptim të dispozitës Kushtetuese, konkretisht nenit 45 paragrafi 1 dhe 2, si dhe me qëllim të realizimit të plotë të vullnetit të qytetarëve të Kosovës, duke ju dhënë e drejta të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Kosovës, përmes votës demokratike me të cilën kërkojnë nga PZAP që të urdhërohet KQZ ti bartë në QNR, 4639

pako me fletë votime për numrim, të dërguara me postë nga qytetarët të cilet jetojn jashtë Kosovës.

Në përgjigjën e KQZ të pranuar me 17.10.2019, theksohet se në mbledhjen e KQZ-së të datës 12.10.2019, numër 50/2019, një ndër pikat e rendit të ditës ka qenë edhe raporti lidhur me procesin e votimit jashtë Kosovës. Raporti lidhur me pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, i departamentit të operacioneve zgjedhore-divizioni i shërbimit votues (DVSH), e ka njoftuar KQZ-në lidhur me pranimin e dërgesave postare pas afatit të periudhës së votimit përmes postës, se me datën 10 tetor 2019, në postën numer 6, janë pranuar 4058 dërgesa postare, të cilat konsiderohen si dërgesa që kanë arritur pas afatit të priudhës së votimit përmes postës. Në vazhdim theksojnë se në raportin e DVSH-së konstatohet se, sipas numrimit dhe verifikimit të këtyre zarfeve, këto dërgesa postare janë nisur për në Kosovë, brenda periudhës së votimit. Numri i kosiderushem i këtyre dërgesave postare, si datë të nisjes kanë datat 19,20,23,25 e deri me 30 shtator 2019, dhe në bazë të nenit 96.2 LZP, dhe rregullës 03/2013, votimi jashtë Kosovës, pika 4.4, votat jashtë Kosovës duhet të pranohen nga KQZ, 24 ore para ditës së Zgjedhjeve.

Në plotësimin e përgjigjes në apel të datës 18.10.2019 konfirmojnë se raporti i prezentuar nga departamenti i operacioneve zgjedhore – Divizioni i Shërbimit Votues(DVSH) në mbledhjen e KQZ-së të datës 12.10.2019, nr.50/2019, lidhur me pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosove ka qenë rapor informues dhe KQZ-ja në këtë mbledhje nuk ka marrë vendim por ka kërkuar nga departamenti i operacioneve zgjedhore- Divizioni i shërbimeve Votues(DVSH), që lidhur me rastin në fjalë ta zbatoj LZP përkatësisht nenin 96.2 të LZP-së dhe Rregullës 03/2013, votimi jashtë Kosove, pika 4.4.

PZAP, në kuptim të nenit 3 par.8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesën në fjalë vendosi ta trajtojë si apelim, duke konsideruar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat.

Paneli konstaton se pretendimet ankimore për mos numërimin e 4639 pako me fletëvotime të ardhura me postë nga qytetarët të cilën jetojnë jashtë Kosovës, e të cilat ende nuk kanë ardhur dhe numëruar në QNR, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja ende nuk ka marrë vendim lidhur me numërimin e këtyre fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, ashtu siç del edhe nga vet përgjigja në ankesë e KQZ-së e parashtruar më datën 19.10.2019. Raporti i prezantuar nga departamenti i operacioneve zgjedhore-Divizioni i shërbimit votues, lidhur me pranimin e pakove me fletëvotime nga votuesit jashtë Kosovës, ka qenë raport informues në mbledhjen e KQZ-së të datës 12.10.2019, nr.50/2019 dhe në këtë mbledhje nuk është marrë vendim nga KQZ-ja por nga departamenti i operacioneve zgjedhore- Divizioni i Shërbimeve Votues, në lidhje me rastin në fjalë, është propozuar ta zbatojë nenin 96.2 të LZP-së dhe nenit 4.4 të rregullës 03/2013.

Meqenëse në rastin konkret nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, prandaj paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit , të vendosë lidhur me numërimin e fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, ngase sipas nenit 122.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht me dispozitën e sipërshënuar. Në këtë

rast nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendimi lidhur me numërimin apo refuzimin për rinumërim të 4639 pako me fletëvotime të ardhura nga votuesit jashtë vendit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, ta paraqes sërish ankesë, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.375/2019 më datën 19.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gylberth Sylaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.